

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detajet/ Vlora Hyseni me “arrest shtëpie”, qëndroi në Kosovë dhe iu dorëzua autoriteteve në Morinë - Inf ormohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/detajet-vlora-hyseni-me-arrest-shtepie-qendroi-ne-kosove-dhe-iu-dorezua-autoriteteve-ne-morine/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:46:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 18:52:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c19e2194bc27b28d90e78b3d820acebc57538a289fec40ed523af10a4a0f05e6
TEKSTI	dcfc64a177d93896410722d48ef6e4fbdfe3d911a5a0c5cf0f191985bda4806f
PAMJA	f1121e3ff5733ad3540aa7e9e752737b35fd469e45baf25ce3c80a68ce690ccc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2e7b61dd17116050558d5852e60326fc232c525244b91803703aa4e6cf6ab83a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2e7b61dd17116050558d5852e60326fc232c525244b91803703aa4e6cf6ab83a

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Detajet/ Vlora Hyseni me “arrest shtëpie”, qëndroi në Kosovë dhe iu dorëzua autoriteteve në Morinë

AKTUALITET

Demo

Detajet/ Vlora Hyseni me “arrest shtëpie”, qëndroi në Kosovë dhe iu dorëzua autoriteteve në Morinë

SEPTEMBER 22, 2026



Drejtoresha e Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), Vlora Hyseni, ndaj së cilës Prokuroria e Posaçme (SPAK) ka caktuar masën e sigurisë “arrest në shtëpi”, është ndaluar në pikën kufitare të Vermicës dhe më pas është dorëzuar te autoritetet shqiptare në Morinë.

Sipas raportimeve të mediave në Kosovë, Hyseni ka qëndruar gjatë ditës në Kosovë, ndërsa më pas është paraqitur te autoritetet shqiptare në pikën kufitare të Morinës, ku është ndaluar. Pas ndalimit, ajo është shoqëruar nën eskortë policie dhe pritet të transportohet drejt Tiranës, ku do t'i komunikohet zyrtarisht masa dhe akuzat e ngritura ndaj saj.

Në momentin kur SPAK kërkoi dhe gjykata caktoi masën e sigurisë, Hyseni nuk ndodhej në Shqipëri. Ajo ishte në Baku të Azerbajxhanit, ku merrete pjesë në një konferencë ndërkombëtare.

Më herët, kryeministri Edi Rama njoftoi se kishte vendosur ta lironte nga detyra drejtoreshën e SHISH, disa orë pasi u bë publik informacioni se SPAK kishte kërkuar pezullimin e saj nga detyra dhe vendosjen nën masën e “arrestit në shtëpi”.

Sipas hetimeve të Prokurorisë së Posaçme, Vlora Hyseni akuzohet për veprat penale “përkrahja e autorit të krimit” dhe “nxjerrja e sekreteve shtetërore”.

Masa e sigurisë ndaj saj lidhet me një hetim të SPAK për Ergys Agasin, i dyshuar për krijimin e një grupi të strukturuar kriminal me qëllim manipulimin e procedurave të tenderimit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Hyseni tashmë pritet të mbërrijë në Tiranë, ku do të vijojë procedura për ekzekutimin e masës së sigurisë të caktuar ndaj saj.

Vlora Hyseni

SHARE.

Postimet e reja

Arrestohet në Rusi një nga personat më të kërkuar...

SEPTEMBER 23, 2026

E ardhmja e Merz nën presion, 45% e...

SEPTEMBER 23, 2026

Ish-producenti i Hollywood-it Harvey...

SEPTEMBER 23, 2026

Presidentja në detyrë i ftoi në takim, familjet...

SEPTEMBER 23, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 22, 2026

Kreditorët të dera, gjykata në kërkim të “Top Fruits” të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Situata financiare e një prej ish-gjiqantëve të grumbullimit dhe eksportit të fruta perimeve, “Top Fruits”....

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbapsht

Na ndiq

[Facebook](#)[Instagram](#)[YouTube](#)[TikTok](#)

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët,
mundësi fitimi dhe sfida në punë,
çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3
shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.